



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 01 shkurt 2021, në mbledhjen e XXXIII-të (tridhjetë e tretë) mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, kati përdhes, dhe filloi në orën 10:15

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Arlinda Kadriu, Fatlume Jaha, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica, Endritë Murati, Patriot Rudari, përveç Vendenis Lahu i cili ka dhënë dorëheqje nga pozita e këshilltarit të Kuvendit të Komunës në Podujevë.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin; Avni Fetahu drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, Fevzi Jetullahu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSH, Bahri Selimi, drejtor i Drejtorisë së Administratës – DA, Bahrije Shatrolli Mehmeti, drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë - DPKGJ.

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje, ndër të tjera shtoi, besoj që thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje e keni marrë të gjithë me kohë, andaj nëse dikush nga anëtarët e pranishëm dëshiron fjalën, urdhëroni, nëse dikush nuk ka diçka për të shtuar atëherë unë e vë në votim rendin e ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, në seancën e kaluar të Kuvendit, nga këshilltari i Kuvendit nga radhët e PDK-ës z.Pajtim Hodolli ka pas një propozim që të shqyrtohen mundësitë për kompensimin e personave të prekur me covid-19, andaj propozoj që të futet si pikë shtesë e rendit të ditës kompensimi për personat e prekur nga virusi covid-19 në Komunën e Podujevës.

Jemi në dijeni se një numër i Komunave të Kosovës tash më veç kanë marrë vendime të tilla dhe kanë bërë kompensim për personat e infektuar me këtë virus, dhe në këtë kontekst Komuna e Podujevës ka një numër të madh të qytetarëve të infektuar andaj një ndihmë sado e vogël do të ishte ndihmë shumë e madhe për këta persona dhe familjet e tyre.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, para se ta vë në votim këtë pikë të rendit të ditës kërkoj nga ju si propozues i kësaj pike që të përcaktoni një shumë për secilin individ të prekur nga virusi covid-19.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, për propozimin në fjalë nuk mund të caktojme një shumë monetare pasi që nuk kemi të dhëna të sakta për personat e prekur, kurse në aspektin teknik dhe procedural kjo pikë hynë në redn të ditës në këtë mbledhje, e njëjta shqyrtohet dhe varësisht disponimit pastaj i rekomandohet apo jo Kuvendit për shqyrtim të mundësive dhe miratim eventual duke marrë përbazë

edhe qëndrimin e drejtorisë së buxhetit dhe Financave rreth shumës dhe buxhetit që mund të ndahet për këtë çështje.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, hedh në votim propozimin e anëtarit z.Rafet Llapashtica për futje si pikë shtesë në kuadër të rendit të ditës për këtë mbledhje me mundësi që e njëjta t'i rekomandohet edhe Kuvendit për shqyrtim.

Njëzëri nga anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa u mbështet që të përfshihen si pikë shtesë në kuadër të rendit të propozuar të ditës (në pikën 8), si vijon:

- **Propozim për mbështetje financiare për personat e prekur (infektuar) nga coronavirusi Covid-19 në territorin e Komunës së Podujevës**

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës, përfshirë edhe pikën shtesë të lartcekur.

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtura më 30 tetor 2020, 23 nëntor 2020 dhe 7 dhjetor 2020

Njëzëri u miratuan procesverbalet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur mbajtura më 30 tetor 2020, 23 nëntor 2020 dhe 7 dhjetor 2020

2. Informatë e përgjithshme e Drejtorisë së Arsimit

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit - DKA, theksoi, konsideroj se informatën e keni marrë me kohë dhe keni pasë mundësi ta lexoni dhe analizoni. Mund të shtoj se kjo Informatë përveç tjerash përfshinë investimeve kapitale në fushën e arsimit, investimet për pajisje me teknologji informative, investime në shkollë si dhe aktivitetet tjera rreth Drejtorisë dhe procesit mësimor gjatë vitit përkatës. Pra është një informatë e përgjithshme e DKA-së e që mund të them se për herë të parë është kërkuar një informatë e tillë e përgjithshme.

z.Mehmet Gashi, theksoi, Grupi i këshilltarëve të LDK-së e kemi trajtuar këtë informatë dhe i rekomandojmë Kuvendit për diskutim.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, nëse nuk ndokush diçka rreth kësaj pike, kush jeni që kjo Informatë t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim në seancën e thirrur për datë 03.02.2021.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim

3. Informatë e përgjithshme e Drejtorisë së Administratës

z.Bahri Selimi, drejtor i Drejtorisë së Administratës - DA, theksoi, para vetës keni informatë të përgjithshme për punët dhe aktivitetet e Drejtorisë së Administratës, informatë e cila është parapar në rend të ditës duke marrë për bazë edhe planin e punës së Kuvendit, andaj si e tillë është përgatitur dhe dërguar me kohë, keni pasë mundësi ta analizoni dhe ta trajtoni, andaj nëse nuk ka diçka nga ana juaj, kjo pikë mund t'i rekomandohet Kuvendit ku edhe mund të diskutohet më gjerësisht.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, ftoj të marrin fjalën kush do që ka interesim por meqë nuk pati të lajmëruar e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim

4. Plotësimi i përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa pas dhënies së dorëheqjes së një këshilltari nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, sigurisht jeni në dijeni se ish këshilltari i Kuvendit dhe anëtari i këtij Komiteti z.Vendenis Lahu nga radhët e LVV-së ka dhënë dorëheqje nga funksioni i këshilltarit të Kuvendit dhe rrjedhimisht edhe nga KPF, andaj kërkohet të bëhet plotësimi i KPF-së respektivisht zëvendësimi i anëtarit në fjalë.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe dhënie të propozimit për plotësimin e përbërjes së KPF-së.

5. Kërkesa e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë për ri shqyrtimin e propozim vendimit për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin 2021 (sipas materialit nga mbledhja 30.12.2020)

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, kemi të bëjmë me këtë propozim vendim i cili në mbledhjen e kaluar të Kuvendit të mbajtur në fund të muajit dhjetor 2020 nuk është miratuar.

Sipas ligjit Komuna duhet të publikon listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme të Komunës, si dhe listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin vijues deri me 31 dhjetor të çdo viti.

z.Mehmet Gashi, theksoi, të gjithë jemi në dijeni se këtë pikë / propozim vendim e kemi shqyrtuar në mbledhjen e kaluar të Kuvendit, e njëjta është hedhë në votim mirëpo nuk ka marrë votat e mjaftueshme për të kaluar, pra nuk ka kaluar. Vendimet e mbledhjes së kaluar të Kuvendit sigurisht që janë dërguar në Ministrinë e Pushtetit Lokal-MPL për vlerësim të ligjshmërisë, mirëpo ne kemi marrë një informatë se Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ i është drejtuar MPL-së me një shkresë lidhur me propozim vendimin e cekur kur jemi në dijeni se afati kohor për dhënien në shfrytëzim është deri më 31 dhjetor, prandaj tani jemi në një situatë ku nuk e dimë se a është e ligjshme apo jo ky propozim vendim dhe kjo listë e veçantë e pronave që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2021 kur e njëjta sipas ligjit parashihet që të publikohet para 31 dhjetorit të çdo viti.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, shkresa është bërë nga DPKGJ për MPL-në, është marrë një përgjigje përmes e-mail, it më datë 22 janar 2021, të cilën sa për njoftim unë po e lexoj: *Ministria e Pushtetit lokal sqaron se bazuar në ligjin nr.06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme dhe rregulloren nr.09/2020, komuna përgatit dhe publikon listën e veçantë me prona që planifikon të jepen në shfrytëzim gjatë viti vijues. Prandaj Lista e veçantë e pronave të paluajtshme të komunës të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2021 mund të vendoset në pikat e rendit të ditës në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës së Podujevës.*

Pra ky është sqarimi i MPL-së, në qoftë se dikush ka diçka për të shtuar urdhëroni nëse nuk ka e vë në votim edhe këtë pikë të rendit të ditës.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit të thirrur për datë 03.02.2021, sipas thirrjes dhe materialit të dërguar për këtë pikë në mbledhjen e Kuvendit të datës 30.12.2020

6. Kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit për plotësimin ndryshimin e vendimit nr.01-104/02-0065942/20 të datës 30 tetor 2020 për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim SH.A. Podujevë (riformulim i nenit 2, me tekstin: “Kryetari i Komunës me vendim të veçantë emëron një anëtar në kuadër të këtij komisioni”)

z.Fevzi Jetullahu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpëtim-DSHPMSH, theksoi, është futë si pikë e rendit të ditës kjo çështje dhe ka të bëjë me riformulimin e nenit 2 të vendimit përkatës të fundit me të cilin janë emëruar dy anëtar në Komisionin Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim Sh.A. në Podujevë dhe krejt kjo ka ardhë si rrjedhojë e dorëheqjes së ish dy anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe zëvendësimit të tyre nga dy anëtar të rinj përkatësisht plotësim ndryshimi i vendimit nr.01-104/02-0065942/20 të datës 30 tetor 2020 për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim Sh.A. në Podujevë, konkretisht riformulimi i nenit 2, që duhet të riformulohet si në vijim: Kryetari i Komunës me vendim të veçantë të emëron një anëtarë në kuadër të komisionit përkatës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, si do që të jetë kjo çështje, mbetet të shqyrtohet nga ana e Ekzekutivit të Komunës, andaj ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së e rekomandojmë për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim

7. Raporti i punës së Kuvendit të Komunës/ Komiteti për Politikë dhe Financa për vitin 2020

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, konsideroj se raportin dhe materialin përkatës e keni marrë me kohë dhe keni mund ta lexoni dhe analizoni, raport në të cilin përfshin edhe Komitetin për Politikë dhe Financa dhe është i detajuar, andaj urdhëroni kush dëshiron fjalën për ndonjë vërejtje, sugjerim apo plotësim ndryshim eventual, nëse jo e hedh në votim që i njëjti ti rekomandohet Kuvendit për diskutim.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim

8. Propozim për mbështetje financiare për personat e prekur (infektuar) nga coronavirusi Covid-19 në territorin e Komunës së Podujevës

z.Rafet Llapashtica, theksoi, si propozues i kësaj pike në këtë mbledhje kërkoj që të bëhet shqyrtimi i mundësive për mbështetje financiare për personat e prekur nga covid-19 në territorin e Komunës së Podujevës, mirëpo do të ithe mirë dhe propozoj që shuma të jetë në bazë të mundësive financiare të Komunës dhe me këtë rast edhe kërkoj nga drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave të shqyrtojë

mundësinë se nga cila kategori buxhetore mund të ndajë një shumë të caktuar për ndihmë personat në fjalë.

Po ashtu për seancën e radhës të Kuvendit të Komunës kërkoj që të sjellën materialet së bashku me planin e punës të KKSB-së duke përfshirë raportin financiar dhe raportet e policisë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, pra kemi për shqyrtim këtë pikë që u propozua nga këshilltari zotëri Llapashtica, mirëpo që për shumën që duhet të ndahet për personat e infektuar me covid-19 si përfundim mbetet që në seancën e Kuvendit të propozohet nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave varësisht mundësive buxhetore të Komunës, natyrisht nëse veç është disponimi për miratim nga ana e Kuvendit, andaj meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën unë e hedh në votim.

Pas votimit njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim

Kryesuesi i Komitetit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:36

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.01-060/04-0007471/21
Podujevë,
01 shkurt 2021**

**Kryesuesi i Komitetit
Fatmir Gashi**